



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.535/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e Mehmet Gashi kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Podujevë, nga radhët e subjektit politik (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Podujevë, për shkak të parregullsive në ditën e votimit, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 31.10.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**HUDHET** si e pa lejuar ankesa e Mehmet Gashi kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Podujevë, nga radhët e subjektit politik (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Podujevë, me shenjen ZL.Anr.535/2017 të datës 27.10.2017, për shkak të parregullsive në ditën e votimit, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017,

### A r s y e t i m

Më datën 27.10.2017, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Mehmet Gashi kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Podujevë, nga radhët e LDK-së, me të cilën pretendon se bazuar në shënimet e vëzhguesit nga LDK-Podujevë z. Muharrem Haliti, në vendvotimin 1822E01R, të nxjerra nga shënimet e mbajtura nga leximi i kandidatit me nr. 4, Mehmet Gashi i ka pasur 34 vota, ndërsa në formularin e FRK janë evidentuar 24 vota. Më tej thekson se të njëjtit i mungojnë 10 vota.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

#### **Ankesa është e pa lejuar**

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar, në ankesën e parashtruar përkitazi me manipulimin e votave në vendvotimet e cekura në ankesë, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrohen pas shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar, mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj paneli vendosi që ta hudh si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hudhja e ankesës së ankuesit nuk e paragjykon çështjen se

ankuesit i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, që të paraqes ankesë tjetër, pas shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
Anr.535/2017 më datën 31.10.2017.



**Kryesuese e Panelit**  
**Hasan Shala**

**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*